



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 28 janar 2019, në mbledhjen e IX-të (nëntë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.25’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës dhe shtoi, andaj nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Njëzëri u votua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar.

1. Ekstraktet e procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa më: 01 nëntor 2018 dhe 29 nëntor 2018

Njëzëri u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura:

- më 01 nëntor 2018

- më 29 nëntor 2018

2. Raporti i punës së Kuvendit për vitin 2018

z.Fatmir Gashi, Kryesues, dha sqarimet rreth këtij raporti, shtoi, ky raport pasqyron të gjitha punët dhe aktivitetet e Kuvendit gjatë vitit 2018, dokument të cilin besoj se e kanë analizuar të gjithë, andaj nëse dëshiron ndokush të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo mund t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

3. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, jeni në dijeni se këtë propozim plan e kemi hartuar dhe përgatitur bashkërisht me të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuara në këtë Kuvend. Janë paraparë të gjitha pikat që ne kemi menduar se është mirë të shqyrtohen, si dhe kemi lënë hapësirë që gjatë vitit varësisht nevojave të Ekzekutivit të shqyrtohen edhe pika – propozime tjera. Vlen të theksohet se Ekzekutivi i Komunës respektivisht Drejtorët e Drejtorive kanë pas kohën e caktuar deri kur kanë mund të paraqesin pikat-temat të cilat do t'i procedojnë për Kuvend, dhe të gjitha ato që janë dërguar, si Kuvend i kemi marrë parasysh dhe i kemi inkorporuar në këtë dokument. Ky propozim plan është i hapur për të gjitha ato çështje të cilat janë në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës, Ekzekutivit dhe Kuvendit të Komunës, andaj nëse ndokush ka diçka të shtoj urdhëroni.

z.Avni Fetahu, theksoi, ashtu siç e potencoj Kryesuesi është e vërtetë se kemi hartuar një propozim plan të punës së Kuvendit për vitin 2019, dokument të cilin nuk e kemi konsideruar si përfundimtarë. Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së rekomandojmë që i njëjti të rekomandohet në Kuvendin e Komunës duke lënë mundësinë e pasurimit të këtij plani edhe me ndonjë pikë që mund të jetë me interes për qytetarët por edhe për Ekzekutivin e Komunës.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së nuk kemi çfarë të shtojmë sepse këtë propozim plan e kemi përpiluar bashkërisht. Është gjë e mirë që ashtu siç e kemi përpiluar, i njëjti është sjellë në Kuvend, andaj nuk kemi as çfarë të ndryshojmë e as çfarë të shtojmë ose heqim, por vetëm e mbështesim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, është e vërtetë që këtë dokument e kemi hartuar bashkërisht, ndërsa prej Ekzekutivit të Komunës kemi pasë këto pika, nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik 2 pika dhe 1 pikë nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kështu që ne ndoshta jemi ndier paksa të hendikepuar sa i përket sinkronizimit të këtij propozim plani sepse nuk kemi pas kërkesa ose ndonjë planë të punës nga ana e Drejtorive për të përfshirë në këtë propozim plan. Unë jam në dijeni se ne si Kuvend jemi të obliguar që çdo projekt që është në interes ne mund të fusim edhe si pika të jashtëzakonshme, mirëpo në një formë të gjitha pikat tjera që sjellën në Kuvend e që nuk janë në kuadër të planit mund t'i konsiderojmë si pika të jashtëzakonshme për arsye se nuk ka pas ndonjë planifikim nga ana e Drejtorive edhe përkundër asaj që siç jemi njoftuar Kryesuesi i Kuvendit ju ka bërë kërkesë të gjitha Drejtorive që të sjellin pikat të cilat planifikojnë të sjellën në Kuvend gjatë vitit 2019, me qëllim të përfshirjes së tyre në këtë dokument. Si do që të jetë ne i kemi parashikuar këto pika të cilat janë përfshirë në këtë propozim plan. Një kërkesë e cila ndoshta ka mbet paksa diskutabile e cila ka të bëjë me raportin e Klubit të Futbollit Llapi, gjë për të cilën pothuajse për dy vite kemi bërë kërkesë për një raport të tillë nga ana e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit por që asnjëherë deri tani nuk na është sjellë, unë sot nuk po dëshiroj të them asgjë rreth kësaj kërkesë por besoj se në Kuvend do të ketë kërkesë të tillë ngas ka pasë kërkesë të vazhdueshme dhe nuk ka qenë në gjendje të raportoj për gjendjen

e KF Llapi, përkatësisht do t'i ketë disa pyetje konkrete rreth kësaj çështje, andaj si do që të jetë nëse në këtë muaj jo, në muajin tjetër ndoshta do të ketë kërkesë edhe me shkrim për këtë çështje.

Rreth propozim planit nuk kam diçka tjetër, por vetëm uroj të miratohet i njëjti dhe të realizohet, andaj e mbështesë që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, mirëpo nëse vazhdojmë në këtë formë me vetëm pikat e parapara nga këshilltarët e Kuvendit ku realisht i bie që ne vetëm kemi miratuar se kur do të mbahen seancat ndërsa presim çka do të sjellët nga Ekzekutivi dhe të miratojmë ngase nuk kemi tema të planifikuara nga Drejtoritë e Komunës e që nuk do të jenë në numër të vogël në fusha të ndryshme, andaj mendoj se në këtë aspekt Drejtorët e Drejtorive janë treguar jo shumë efikas edhe përkundër asaj që kanë qenë të njoftuar rreth 2-3 muaj përpara se ky plan do të hartohet.

Vlen të theksohet se ne si Kuvend nuk kemi buxhet të ndarë për shpenzime të ndryshme qoftë të Kryesuesit qoftë të këshilltarëve për çështje të ndryshme, vizita zyrtare, pritje të delegacioneve, vurje të kontakteve për binjakëzime, pije në seanca etj të ngjashme, kështu që nuk kemi edhe çka të raportojmë rreth punës së Kuvendit, e që në një mënyrë i bie të jemi në shërbim të Ekzekutivit të Komunës, andaj kjo çështje të merret parasysh kjo dhe të ndahet buxhet 4-5 mijë euro.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa jam në dijeni ky propozim plan është përgatitur nga gjithë anëtarët e Kuvendit, shpresoj se i njëjti do të begatohet edhe pika – tema tjera të cilat sigurisht se do të rrjedhin gjatë vitit nga Drejtori të ndryshme që ne ndoshta nuk kemi mund t'i planifikojmë, edhe pse ne si Drejtori planet tona i kemi.

Më pëlqeu planifikimi që është përcaktuar që në muajin shkurt të jetë plani vjetor i KKSB-së si dhe në muajin mars të jetë raporti i punës së këtij Këshilli, çështje të cilat na përputhen edhe me planet që kemi si KKSB. Sa i përket DSHPMSH vërejtja se janë paraparë dy tema, përkatësisht është kërkuar që në muajt korrik dhe nëntor të paraqesim raporte, e që në parim ne pajtohemi, madje jo vetëm në këta muaj por kurdo që kërkohet nga Kuvendi dhe për çfarëdo qoftë, mirëpo duke parë se thuhet raport, nuk di se çfarë është menduar ngase në raste të tilla zakonisht kërkohen informata. Mendoj se raportet kanë karakter tjetër siç janë raportet financiare etj të ngjashme, andaj kërkoj të dijë se çfarë është kërkuar konkretisht sepse konsideroj se, ta zëmë po të paraqitet një raport i DSHPMM në muajin korrik, gama është bukur e madhe. Pra a është menduar ndonjë informatë rreth gjendjes së Drejtorisë ose rreth shërbimeve të Drejtorisë. Ndoshta nuk është menduar për projektet kapitale sepse ato paraqiten në dokumentet – raportet periodike financiare. Për fund konsideroj se ndoshta më mirë do të ishte të kërkoj informatë e DSHPMSH rreth gjendjes së shërbimeve publike ta zëmë, mirëpo si do që të jetë ne e pranojmë dhe do ta keni para vetës një raport të tillë, por vetëm më tregoni konkretisht çfarë fushe ose teme është menduar.

z.Mehmet Gashi, theksoi, ky propozim plan i punës është hartuar nga ne si këshilltarë të Kuvendit, janë propozuar disa tema por nuk do të thotë që nuk do të paraqiten edhe tema tjera nga ana e Drejtorëve të Drejtorive. Madje kemi menduar edhe nga DPUMM të kërkojmë dokumentin e hartës zonale në muajin maj ose qershor që edhe Drejtori e ceku në mbledhjen e kaluar, por nuk do të thotë që nuk do të mund të silllet ai dokument kurdo që të jetë i gatshëm. Sa i përket Drejtorit parafolës z.Faik Muçiqi i cili pati vërejtje rreth dy pikave të parapara në këtë Drejtori, sa kujtoj është menduar ta kemi një informatë rreth gjendjes së disa shërbimeve komunale siç janë me ujësjellës, mbeturina, problemet me rrymë etj të ngjashme për atë periudhë, e jo raport të karaktereve tjera.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, rreth asaj që Drejtori i DSHPMSH e ngriti, mund të them se fokusi ka qenë që nga kjo Drejtor të kemi një informatë rreth gjendjes në shërbimet komunale që janë në fushëveprimtari të kësaj Drejtorie. Është fakt se ndoshta raport del paksa vrazhdë, mirëpo qëllimi ka qenë të jetë një informatë me të cilën do të informohemi rreth shërbimeve komunale, me theks gjatë kohës së verës, në mënyrë që këshilltarët e Kuvendit të jenë sa më të informuar. Si do që të jetë, raport ose informatë, qëllimi po dihet.

z.Fitim Haziri, theksoi, konsideroj se është mirë të mos ndryshohet kjo pikë, të mbetet ashtu siç e kemi përgatitur ne bashkërisht. Sa jemi në dijeni Drejtorët e Drejtorive kanë qenë të informuar rreth dy muaj më parë, përkatësisht është kërkuar nga Drejtorët të dërgojnë temat – planifikimet e tyre për vitin 2019 në mënyrë që të përfshihen në planin e punës së Kuvendit për vitin 2019, kështu që Drejtorët nuk i kanë paraqitur, andaj nuk kemi nevojë tani të bëjmë ndryshime.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, mua si Drejtor nuk më prish punë asgjë, mirëpo në terminologjinë juridike kanë dallime këto dy terme edhe pse në esencë nuk dallojnë shumë. Drejtoritë e Komunës zakonisht japin informata ndërsa raportet janë diçka tjetër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rreth çështjes së ngritur konsideroj se gjendja nuk ndryshon asgjë, qoftë si informatë qoftë si raport, sepse kemi të bëjmë me gjendjen e shërbimeve publike që i përket fushveprimtarisë në fjalë. Besoj që nëse miratohet ky plan i punës, deri në muajin korrik DSHPM ka kohë të mjaftueshme të përgatitet dhe të paraqesë një dokument të tillë në Kuvend rreth gjendjes së shërbimeve publike në territorin e Komunës së Podujevës. Sigurisht që Drejtori vetëm nuk mund të përgatit por ka edhe stafin e tij të Drejtorisë i cili kryen punët varësisht fushave, qoftë si informatë qoftë si raport, andaj mendoj se nuk prish punë pse figuron raport sepse afati është i gjatë, deri në korrik dhe mund të përgatitet, kurse po të ishte menjëherë në muajin shkurt natyrisht se do të ishte ngarkesë e madhe të përgatitej një raport i tillë, shembull për vitin 2018.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket DPUMM kemi disa planifikime të cilat nuk i kemi futë në planin e punës së Kuvendit për shkak se nuk mund të jemi në dijeni saktësisht se kur do të jenë të gatshme për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, një ndër ato është harta zonale e cila është në përpunim e sipër e që ashtu siç e kam cekur sipas planifikimeve në muajin mars besojmë se do të sjellët drafti i parë, andaj jemi duke punuar mjaftë shumë, sepse kemi pas disa probleme me pronat publike sa i përket identifikimit të tyre, përmbledhjes së tyre dhe futjes së tyre në hartën zonale, por shpresoj që në mars do të jetë drafti i parë dhe pastaj deri në fund të muajit qershor do të përfundojnë edhe procedurat tjera siç janë diskutimet publike etj, dhe do të jetë e kompletuar ky dokument.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, sa i përket këtij propozim plani, mendojmë se kemi përgatitur një plan sipas kërkesave të këshilltarëve dhe Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit. Po ashtu janë përfshirë të gjitha temat – pikat e paraqitura nga ana e Drejtorive, por sigurisht që gjatë vitit ky plan do të plotësohet edhe me pika tjera të cilat janë në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Kërkesa për ndihmë financiare e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi “HANDIKOS” – Podujevë

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, jeni në dijeni se organizata Handikos – Podujevë është një institucion joqeveritar për të cilën jam i bindur se të gjithë jemi në dijeni për aktivitetet e tyre, organizatë e cila ka paraqitur një kërkesë për mbështetje financiare për realizimin e projektit dhe aktivitetëve programore të tyre për vitin 2019, kërkesë të vilën sigurisht që e keni analizuar të gjithë ku gjithashtu keni vërejtur se janë përshkruar edhe aktivitetet e tyre gjatë vitit 2018. Shuma e kërkuar është 14,556.00€, andaj besoj se ka arsye dhe veprimtari të mjaftueshme për punën e tyre që kjo kërkesë të mbështetet nga ana e këtij Komitetit respektivisht edhe Kuvendit të Komunës. Ndoshta për ndonjë çështje të caktuar ndokush mund të kërkon sqarim shtesë, mirëpo të gjitha janë cekur në raportin e punës për vitin 2018 të kësaj organizate, si dhe ndonjë çështje tjetër rreth planifikimeve për vitin 2019 që po ashtu është cekur në materialin përkatës e që janë aktivitete të

domosdoshme që kryhen për një kategori të veçantë të qytetarëve të Komunës së Podujevës, andaj duke pas për bazë të gjitha këto konsideroj dhe njëkohësisht kërkoj nga ju që të mbështetet një kërkesë e tillë.

z.Avni Fetahu, theksoi, natyrisht edhe Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë kërkesë që e njëjta t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me mundësi që ashtu siç e kemi potencuar edhe viteve të kaluara, mbështetja e kësaj shoqate të bëhet në mënyrë edhe më meritore ngase ka me vite që bëhet një kërkesë e tillë me një shumë të njëjtë të mjeteve, kurse veprimtaria dhe aktivitetet e kësaj organizate janë në rritje e sipër dhe njësitë buxhetore të DSHMS sigurisht që kanë mund të jenë edhe më të mëdha dhe të shikoheshin mundësitë për përkrahje edhe më meritore.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe vitin e kaluar kur kemi diskutuar për një kërkesë të tillë kemi thënë se një shumë e tillë për këtë organizatë nuk është e mjaftueshme për këtë kategori, jo vetëm të shikojmë se çfarë ata kanë kërkuar e që është buxhet, por kemi edhe sektorë të tjerë që ata persona kanë nevojë siç është punësimi, infrastruktura adekuate për ata persona etj të ngjashme, do të thotë se nuk është bërë sa duhet për këtë kategori të njerëzve. Pra e mbështesim këtë kërkesë edhe pse e konsiderojmë si jo të mjaftueshme, por me shpresë që në të ardhmen shuma për këtë kategori të jetë më e madhe duke përfshirë edhe përkrahje dhe mbështetje edhe në sektorë tjerë që ndërlidhen me personat e kësaj kategorie në mënyrë që t'iu lehtësohet jeta edhe në aspekte tjera.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve nga PDK e mbështesim buxhetin për Handikos, ashtu siç e kemi mbështetur vazhdimisht këtë kategori. Sa i përket shumës së mjeteve financiare, ne po diskutojmë për të njëjtën që kjo organizatë ka kërkuar, dhe ne e mbështesim të njëjtën. Nuk e di saktësisht sa janë limitet buxhetore për këtë fushë por nëse ka mundësi buxhetore kjo shumë ndoshta do të ishte mirë të rritej sepse vërtetë e meritojnë. Çështje që dua të ceku është se për çdo vit po sjellët një kërkesë e tillë e Handikosit që ata kërkojnë mbështetje vetëm për veprime administrative, shërbime dhe transport, mirëpo jo edhe për gjendjen e kategorive tjera siç janë personat me autizëm, të verbrit dhe kategori tjera të ngjashme. Pastaj jam i informuar se në vitin e kaluar Organizata e veteranëve të luftës kanë paraqitur një kërkesë për mbështetje me një shumë rreth 1,800.00€ e që të paktën do të ishte mirë të merrej dikush me atë kërkesë qoftë edhe një kthim i përgjigjes, negativ ose pozitiv, mandej nga kjo organizatë është kërkuar edhe ta kenë një zyrë, kështu që ndoshta do të ishte mirë të gjenden forma të tilla për mbështetje dhe organizatat në fjalë si dhe do të ishte mirë që në objektin e ri të Komunës mundësisht t'iu ndahet një zyrë e cila do të mbante relacione me institucionin dhe do të lehtësonte shumë disa çështje administrative që ndërlidhen me këtë kategori. Pra unë e ngrita këtë çështje me kërkesë të asaj organizate, kurse nuk jam në dijeni se ku mbërri ajo kërkesë e tyre dhe a është shqyrtuar e njëjta, kështu që do të ishte mirë të njoftohemi më në detaje, si dhe të ju kthehet një përgjigje, qoftë negative qoftë pozitive duke dhënë dhe arsyetimin, pra e ngrita këtë çështje meqë e mora si obligim nga persona që janë në struktura të asaj kategorie, edhe pse ndoshta këtu mund të informohemi nga Drejtori i DBF apo nga Kryesuesi i Kuvendit.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, rreth kërkesës së Handikos mund të them se është bërë kërkesë pothuajse e përhershme që i bëhet Kuvendit disa vite me radhë për mbështetje financiare përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku ne në sektorin përkatës të kësaj Drejtorie kemi ndarë një buxhet prej rreth 14.000,00€, ndërsa kërkesa e organizatës në fjalë është mbi atë buxhet dhe kemi menduar që pjesën tjetër ta plotësojmë prej një buxheti që është i ndarë për raste të tjera, në po atë Drejtori në mënyrë që kërkesa e tyre të mbështetet ashtu siç është paraqitur, kërkesë të cilën e konsiderojmë si minimumin e minimumit që Handikos të vazhdoj me veprimtarinë e saj, por aq kanë kërkuar dhe mundësit tona janë po aq. Natyrisht që kjo shumë është nga të hyrat vetanake sepse nga grandit nuk kemi të drejtë të japim subvencione, jo vetëm për këtë shoqatë por ka edhe shoqatat tjera të cilat kërkojnë mbështetje me shuma shumë më të vogla e të cilat ka mundësi që për 500 – 600 € Kryetari i Komunë me një vendim i mbulon ato kërkesa. Drejtorja e Buxhetit dhe Financave nuk ka të drejtë të ndajë mjete por

vetëm të planifikon në bazë të kërkesave të Drejtorive përkatëse dhe në fund ndarjen finale e bënë Kuvendi i Komunës, por gjatë vitit edhe Kryetari i Komunës bënë miratimin e ndonjë kërkesë me shuma jo të mëdha aq sa lejohet me ligj.

Sa i përket rastit në fjalë që parafolësi z.Rafet Llapashtica e ngriti, unë nuk kam ndonjë informatë se ndokush ka pranuar një kërkesë të tillë, mund të jetë drejtpërsëdrejti në ndonjë Drejtori apo tek zyra e Kryetarit, përndryshe do t'jua ktheja një përgjigje, qoftë pozitive apo negative nëse mua më takonte të jap përgjigje, nëse jo do ta orientoja në Drejtoritë tjera përkatëse, por jo të mbetet pa një përgjigje.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollorë 2018/2019

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

6. Marrja e vendimit për lejimin e shitjes së kontejnerëve në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc - Komuna e Podujevës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, kemi të bëjmë me një rekomandim i cili ka rrjedh nga Komisioni për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, dhe është përcaktuar përmes DSHMS, andaj fjalën hyrëse do ta jap Drejtori i kësaj Drejtorie.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, rreth situatës në atë Lagje veçse jeni në dijeni të gjithë si dhe për projektin e ndërtimit të shtëpive i cili po vazhdon për çdo vit, mirëpo një problematikë e cila po na përcjellë sa herë që po fillojmë të ndërtojmë shtëpitë e reja në atë lagje është mungesa e hapësirës përkatëse, në fakt lirimi i hapësirës për ndërtimin e shtëpive sepse hapësira si tërësi është e caktuar. Me ndarjen e fundit që është bërë ku janë vendosur në shtëpi të reja 20 familje, janë liruar 20 objekte të banimit montazh që janë në atë Lagje, dhe specifike është se ato familje përzgjedhëse nuk kanë qenë të gjitha prej një ose dy objekteve të tilla, mirëpo në bazë të rregullores përkatëse ka rastisë që të jenë nga objekte të ndryshme në kuadër të asaj Lagjeje dhe tani na mbetet si vështirësi që familjet tjera të grumbullohen në objekte tjera në mënyrë që të lirohen hapësira për fillimin e punimeve për ndërtimin e shtëpive të reja. Jam në dijeni se edhe në mandatin e kaluar ka qenë një problematikë e tillë por që ka kaluar përmes këtij organi dhe Kuvendit të Komunës, përkatësisht fjala është rreth lirim të hapësirës për ndërtimin e shtëpive në atë lagje, dhe tani ashtu siç e parashihet Rregullorja, Komisioni ka bërë një rekomandim të ri për dallim nga ai i komisionit paraprak, sipas të cilit ofrohet zgjidhje. Tani për qëllime procedurale unë po e lexoj rekomandimin e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, i cili i është drejtuar Kuvendit, si në vijim;

I. Marrjen e një vendimi për lejimin e shitjes - largimit e objekteve të banimit kontejnerëve të pashfrytëzuar me konstruksion të metalit të tipit montazh, në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc – Komuna e Podujevës.

II. Shitja dhe largimi i kontejnerëve sipas pikës I, të bëhet varësisht nevojave të paraqitura përkatësisht lirim të hapësirave në lokacionin përkatës, në funksion të vazhdim të realizimit të projektit për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, deri në sistemin përfundimtar të të gjitha familjeve, konform Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës.

III. Për iniciimin e procedurave të prokurimit për shitjen e objekteve sipas këtij rekomandimi të obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në rast të paraqitjes së nevojave urgjente për lirimin e hapësirave për ndërtimin e shtëpive në atë lokacion, largimin e përkohshëm të objekteve në fjalë, gjithashtu obligohet të bëjë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

IV. Para inicimit të procedurave të prokurimit për shitje përmes ankandit publik sipas këtij rekomandimi, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Komisioni për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, caktojnë mënyrën e shitjes së objekteve (në pako ose për njësi) si dhe çmimin fillestar.

Pra kërkohet që të lejohet shitja dhe largimi i atyre objekteve të tipit montazh, dhe kompetencat në një formë i barten DSHMS, përkatësisht organit që merret me çështje të caktuara e që është Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, andaj kërkoj të mbështet ky rekomandim në mënyrë që të zhvillohen procedurat përkatëse në funksion të lirit të hapësirave për ndërtimin e shtëpive të reja, deri në përfundim të projektit në tërësi.

z.Avni Fetahu, theksoi, sigurisht që Grupi i këshilltarëve të LDK-së i rekomandon Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës mirëpo do të doja një sqarim paksa sepse ndoshta është specifike kjo çështje. Ne në vitin e kaluar si Kuvend kemi votuar një komision për pasuritë që ka Komuna, tokat e gjithçka tjetër që ekziston, andaj mos po komplikohet paksa shumë kjo çështje që ka të bëjë me lejimin e shitjes së atyre kontejnerëve në atë Lagje, edhe pse pajtohem që nuk ka diskutim se lirohet hapësirë dhe mundësi për vazhdimin e ndërtimit të shtëpive të reja, por me gjithë këtë varg të komisioneve, komiteteve, rekomandimeve dhe në fund përfundimi është tek prokurimi, andaj do të doja që nëse ka ndonjë bazë ligjore rreth kësaj. Unë do t'ju kërkoja falje këtu nëse është e nevojshme patjetër të merret një vendim për këtë çështje, por më duket se krejt kjo kohë e harxhuar për themelim të komisioneve, komiteteve për një çështje që mendoj se do të kryhej me një komision të veçantë prej Ekzekutivit të Komunës i cili mund t'i vlerësoj ata kontejnerë të cilët duhet të largohen dhe të fillojnë procedurat e prokurimit, pra janë gjëra të qarta ku Drejtoria merr përgjegjësi vetëm si njësi e kërkesës që ka bërë dhe pastaj prokurimi ka për obligim t'i zhvilloj procedurat e mëtutjeshme. Nuk po e them se kjo nuk ka mund të kryhet më herët, por edhe nëse ka ndodh ka qenë gabim po mendoj, dhe po ashtu mendoj se është pak e tepërt të ngarkohen edhe Drejtoria edhe Komisioni por edhe neve si këshilltarë të Kuvendit për një çështje e cila ndoshta do të mund të realizohej në mënyrë më të shpejtë.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, nëse është mundshme Zyra ligjore të na sqaroj paksa rreth kompetencave dhe përgjegjësi lidhur me këtë çështje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ndoshta tani për tani nuk mund të jepet një sqarim apo mendim i tillë.

Nga zyra ligjore, u dha sqarimi se kjo çështje është paraparë në Rregulloren për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, e cila është hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe është miratuar në Kuvendin e Komunës, Rregullore e cila përcakton qartë se komisioni përkatës rekomandon për largimin e kontejnerëve në funksion të lirit të hapësirave për ndërtimin e shtëpive të reja. Gjithashtu njoftoj të pranishmit se një vendim i tillë për shitjen e një numër të caktuar të kontejnerëve është marrë nga Kuvendi i Komunës 2-3 vite më parë dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse nga ish drejtori paraprak i DSHMS, andaj edhe konsiderohet si një praktikë më e mirë e mundshme duke pas parasysh se shtëpitë e banimit – kontejnerët në fjalë janë pasuri e Komunës dhe për të njëjtit vendos Komuna, rrjedhimisht Komisioni është trup i Kuvendit dhe i përgjigjet, rekomandon, propozon Kuvendit të Komunës.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, unë po e them se jo me dëshirë jam marrë me këtë çështje dhe më me dëshirë do të doja që dikush tjetër të merret me këtë sepse mendoj se ka organe më kompetente se sa DSHMS, dhe pajtohem me z.Avni Fetahun rreth përgjegjësi dhe kompetencave ngase DSHMS nuk ka njohuri të mjaftueshme profesionale për t'i proceduar gjërat sikurse që kemi të

bëjmë me këtë që po debatojmë. Mirëpo është çështje e cila është përcaktuar në mënyrë të veçantë me një pikë të caktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Komunës dhe MPMS, ku DSHMS-së i jepet kompetencë edhe për ndarjen e shtëpive përfituesve por njëkohësisht edhe për lirin e hapësirave, pra aty përcaktohet kompetenca, mirëpo unë mendoj që ndoshta nuk ja vlen të merremi shumë me këtë çështje por me rëndësi është të kryhet.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, një numër i familjeve janë vendosur në shtëpi të reja, mendoj se tani nuk është sezoni i përshtatshëm për të bërë lëvizje në atë Lagje sepse jemi në dimër dhe kemi mot të ftohtë andaj ri sistemimi i familjeve në këtë kohë nuk është i përshtatshëm. Mund të ketë raste ku në një kontejnerë të ketë vetëm një familje për momentin sepse tjerat sipas vlerësimit të Komisionit kanë qenë përfitues të shtëpive, pra nëpër kontejnerë janë pakuar familjet, andaj do të ishte mirë të zhvendoseni ato familje në një kontejner të vetëm në mënyrë që të lirohet hapësirë për ndërtimin e shtëpive dhe gjithsesi hapësira duhet të lirohet, por edhe njëherë e përsërisë që në këtë sezoni mund të ketë probleme sa i përket sistemimit për shkak të motit të ftohtë, kjo që e them nuk është ndonjë problem por konsideroj se ndoshta do të ishte mirë të merrej parasysh koha e sistemimit të familjeve.

Sa i përket Memorandumit që ka qenë mes MPMS dhe Komunës, po ta trajtojmë juridikisht, ka bërë lehtësimin e punës për komisionin dhe për Komunën në përgjithësi për arsye se është konsideruar se Komisioni në fjalë planifikon dhe merret vazhdimisht me çështjen e ndarjes së shtëpive, lirimit të hapësirave dhe çështje tjera të nevojshme ngase nuk është e logjikshme që Kryetari i Komunës apo Drejtori i Drejtorisë përkatëse të merret me ato çështje. Pastaj nuk është obligative që në funksion të lirimit të hapësirës menjëherë të bëhet shitja e atyre kontejnerëve sepse janë disa proceduar që duhet respektuar paraprakisht. Nuk e di si është gjendja në atë lagje por nëse paraqitet nevoja urgjente duhet të gjenden të gjitha mundësitë që të bëhet lirimi i hapësirës për ndërtimin e shtëpive të reja. Nëse nuk është urgjente dhe nëse për Drejtorinë nuk paraqet pengesa në terren, ndoshta do të mund të shtyhej kjo pikë për një seancë të radhës në mënyrë që sistemimi i atyre familjeve të bëhet me kujdes nga ana e Komisionit. Sa i përket kësaj pike, nuk them pse e keni sjellë në Kuvend këtë çështje, mirëpo ka pasuri tjera shumë më të vlefshme të cilat janë shitur pa pyetur fare Kuvendin siç ishte rasti i shitjes së automjeteve, kur e them këtë e kam parasysh Udhëzimin Administrativ, i cili shembull, për pajisje të vjetruara vetëm procedohen në Prokurim dhe shiten me çmime shumë të ulta, apo siç është rasti i Llaptopve që ne si këshilltarë i kemi kthyer në bazë të kërkesës së Komunës kurse ato pajisje sipas ligjit zhvlerësohen pas tri viteve, edhe pse janë të përdorshëm. Po ashtu ndoshta do të ishte më mirë që ata kontejnerë banimi të zhvendoseshin nga ai vend dhe të ruheshin, mirëpo sërish do të paraqiteshin probleme rreth sigurisë së tyre sepse të gjithë po shohim çka po ndodh me vjedhje etj. Si do që të jetë ne po i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe bashkërisht edhe njëherë e vlerësojmë si po vendosim, nëse dëshironi edhe tani mund të marrim vendim sepse ata kontejnerë duhet të largohen nga ai vend, madje madje ajo pamje me ata kontejnerë pengon secilin qytetarë të Komunës së Podujevës, por për kohen se kur vlerësoni ju si Drejtori, vendosni si të dëshironi dhe si të vlerësoni kur është e nevojshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, vetëm një sqarim, e jona është vetëm të përkrahim ose jo lejin e shitjes së atyre kontejnerëve si dhe largimin e tyre në funksion të lirimit të hapësirave për ndërtimin e shtëpive të reja, pra të lejojmë apo mos të lejojmë shitjen dhe zhvendosjen e tyre, ndërsa procedurat tjera i merr për sipër Ekzekutivi i Komunës përmes mekanizmave përkatës. Pra e jona si Kuvend është të lejojmë ose jo shitjen e kontejnerëve sipas rekomandimit të Komisioni për ndarjen e shtëpive të cilin e paraqiti Drejtori i DSHMS.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë edhe më parë e ceka se ata kontejnerë duhet të hiqen sepse duhet të lirohen hapësira për ndërtimin e shtëpive. Gjërat që nuk hynë në funksion Komunës duhet të largohen, shiten, zhvendosen ose largohen, andaj nëse Komuna ka vendos t'i shet, atëherë ne marrim vendim për

lejimin e shitjes kurse për çmimet dhe procedura tjera është përgjegjësi direkte e DSHMS, Komisionit përkatës dhe e Prokurimit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, ne po e kuptojmë edhe rekomandimin e Komisionit si dhe kërkesën e DSHMS që nevoja është e domosdoshme të lirohen ato hapësira për ndërtimin e shtëpive të reja, dhe ne në bazë të këtyre arsyeve mund të japim ose jo leje për shitjen e atyre kontejnerëve.

z.Fitim Haziri, theksoi, po diskutohet për lirim të hapësirave për ndërtimin e shtëpive, andaj desha të ndërlihem rreth kësaj ngase është një Lagje e cila qysh në shikim të parë duket si një geto, si dhe ato ndërtime nuk di si janë bërë ashtu pa pasur hapësira, pa oborre, pastaj pa vende të lojërave për fëmijët e lagjes, por edhe pse nuk di si është marrë vendimi për ndërtimin e atyre shtëpive në atë formë, përse nuk mendohet që në të ardhmen të bëhet një ndërtesë kolektive në mënyrë që të mos nxinen gjithë ajo hapësirë me ndërtime të vrazhda, dhe të krijohet një ambiente paska më komod për ata njerëz që jetojnë aty, qoftë me ndonjë fushë sportive, qoftë me ndonjë park qoftë edhe diçka të ngjashme sepse me të vërtetë është kategori që ndoshta është tmerr vetëm të shikohet ai ambient.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa jam në dijeni për një objekt kolektiv nuk ka pas mundësi buxhetore sepse ta zëmë po të shkohej me dy ndërtime nga 5 kate me nga rreth 20 familje për çdo kat, kostojo buxhetore do të ishte e madhe, por këto shtëpi sa jam në dijeni kanë një kosto prej rreth 10,000.00€ dhe janë ndërtuar nga 10-15 shtëpi në faza të ndryshme aq sa është ndarë buxhet.

z.Fitim Haziri, theksoi, unë e ceka se ndoshta do të ishte mirë të mendohej ndryshe sigurimi i banimit për ato familje sepse njëherë lirohen hapësira dhe të njëjtat sërish nxinen me ndërtim, disi nuk po ka kuptim kjo.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, ndoshta vetëm sa për çështje procedurale sepse Drejtori i DSHMS në pjesën e parë u duk paksa i paqartë, andaj për hir të procesverbalit desha të jap një sqarim sepse kishte një konfuzitet ngase kemi të bëjmë me Komisionin për ndarjen e shtëpive. E ndjejë për obligim nga këndi i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ta them këtë, që ky rekomandim është sjellë nga Komisioni për ndarjen e shtëpive e jo ashtu siç u tha nga Komiteti sepse ky Komitet është themeluar nga Kuvendi me mandat për aq sa ka edhe Kuvendi, kurse në mandatin e tij rreth kësaj çështje ka qenë vetëm shqyrtimi i ankesave që janë si rezultat i këtij procesi, mirëpo kjo nuk do të thotë që largon nga përgjegjësia këtë Komitet që në të ardhmen të kujdeset për çfarëdo çështje që bie në domenin e mirëqenies sociale për të gjithë banorët e Komunës së Podujevës, pra kjo ishte vetëm sa për sqarim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, besoj se u sqaruam të gjithë rreth kësaj çështje, andaj e hedh në votim që kjo çështje t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim sipas rekomandimit të paraqitur nga Drejtori i DSHMS-së.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim sipas rekomandimit të Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, prezantuar nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si vijon:

I. Marrjen e një vendimi për lejimin e shitjes - largimit e objekteve të banimit kontejnerëve të pashfrytëzuar me konstruksion të metalit të tipit montazh, në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc – Komuna e Podujevës.

II. Shitja dhe largimi i kontejnerëve sipas pikës I, të bëhet varësisht nevojave të paraqitura përkatësisht lirit të hapësirave në lokacionin përkatës, në funksion të vazhdimit të realizimit të projektit për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, deri në sistemin përfundimtar të të gjitha familjeve, konform Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës.

III. Për iniciimin e procedurave të prokurimit për shitjen e objekteve sipas këtij rekomandimi të obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në rast të paraqitjes së nevojave urgjente për lirimin e hapësirave për ndërtimin e shtëpive në atë lokacion, largimin e përkohshëm të objekteve në fjalë, gjithashtu obligohet të bëjë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

IV. Para iniciimit të procedurave të prokurimit për shitje përmes ankandit publik sipas këtij rekomandimi, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Komisioni për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, caktojnë mënyrën e shitjes së objekteve (në pako ose për njësi) si dhe çmimin fillestar.

7. Marrja e vendimit për ndarjen e llaptop-ve

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, meqë kjo çështje është ngritur edhe njëherë, unë e kam marrë një informatë nga sektori përkatës rreth llaptopve që kanë qenë në përdorim të këshilltarëve të Kuvendit në mandatin e kaluar. Gjendja e tyre është si në vijim: të kthyer 33 llaptop, ende të pa kthyer 2 llaptop, në gjendje të rregullt 20 llaptop, me defekte 13 llaptop, gjithsej 35 llaptop. Pra kemi 20 llaptop të cilët janë të gatshëm për t'iu shpërndarë këshilltarëve të Kuvendit, 13 cop janë që nuk mund të riparohen dhe 2 llaptop nuk janë kthyer ende, kjo është gjendja momentale, urdhëroni kush dëshiron të merr fjalën.

z.Avni Fetahu, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, unë po e jap një propozim, kurse pastaj mund të analizojmë bashkërisht dhe të dalim me një vendim përfundimtarë. Mendoj se ata 20 llaptop sa janë, mundësisht t'ju jepen atyre këshilltarëve që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar dhe që të njëjtit i kanë pas në përdorim, kurse për këshilltarët tjerë do të ishte mirë të zhvillohen procedura sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të përfitojnë – pajisen me llaptop të gjithë këshilltarët. Ndoshta ju bie të presin një kohë por të paktën llaptopët e tyre do të jenë me performanca më të mira se sa që janë këta aktual.

z.Fitim Haziri, theksoi, pajtohem me propozimin e parafolësit z.Avni Fetahu.

z.Mehmet Gashi, theksoi, konsideroj se propozimi i z.Avni Fetahut është shumë real, andaj edhe pajtohem që të jetë ashtu.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, pra pati propozim konkret rreth kësaj çështje me të cilin pothuajse u pajtuan edhe anëtarët tjerë, andaj të deklarohejmë kush është që t'i rekomandohet Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas propozimit të z.Avni Fetahu, si vijon:

- *20 llaptop sa janë, t'ju shpërndahen këshilltarëve të Kuvendit, mundësisht të njëjtit që i kanë pasë në shfrytëzim.*
- *Të zhvillohen procedurat për blerjen e llaptop-ve të rinj dhe t'ju shpërndahen pjesës tjetër të këshilltarëve të Kuvendit.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:25'

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0006723/19

Podujevë,

28 janar 2019

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi